



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.230, datë 13.07.2021

**PËR NDËRPRERJEN DHE PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS PËR PROKURORIN GENTIAN STOJA, KANDIDAT PËR POZICIONIN E DREJTUESIT NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KORÇË**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 159, pika 1 dhe 2 germa "a", 184 dhe 189, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në nenet 32, pika 4, germa "ç", dhe 28, germa "dh", të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në germën "c", të pikës 11, të Seksionit B, të Kreut VI, të Rregullores "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve", miratuar me Vendimin nr. 171, datë 27.9.2019 e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin "Për ndërprerjen dhe përfundimin e procedurës së verifikimit të pasurisë, figurës për prokurorin Gentian Stoja, kandidat për pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë", Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Ndërprejten dhe përfundimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për prokurorin Gentian Stoja, kandidat për pozicionin e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, sipas Relacionit bashkëlidhur.
2. Të njoftohet për këtë vendim z. Gentian Stoja.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**KRYETAR  
GENT IBRAHIMI**



**ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA**



**ANËTAR  
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR  
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR  
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR  
ELOIDA GOXHI**

**ANËTAR  
ESMERALDA KESHI**

**ANËTAR  
MOISI DUDA**

**ANËTAR  
VATË STAKA**

**ANËTAR  
SANDËR BECI**

**ANËTAR  
TARTAR BAZAJ**